



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.30/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, për shkak të vendosjes së posterave në objektet publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), kështu që Koalicionit LDK-AKR, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,200.00 (njëmijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 02.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 01.06.2017 në rrugën Rerandori Deoklician si dhe ne Sheshin Zahir Pajaziti në Prishtinë monitoruesit e tyre kanë hasur në postere të kandidatit për deputet nga koalicioni LDK-AKR të ngjitur në drunj, objekte publike dhe në kiosqe. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara dhe CD lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 03.06.2017, koalicioni LDK-AKR, thekson se pas pranimit të ankesës në përputhje me nenin 120 par 1 pika a) të LZP-së, kanë urdhëruar kandidatin e tyre që të ndërmar veprime përmisuese lidhur me evitimin e shkeljeve të theksuara në ankesë, dhe duke kërkuar nga PZAP-i që të mos i shqiptoj gjorbë pasi që posterat e kandidatit në fjal janë larguar nga aty ku kanë qenë të vendosura.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteritë e kandidatit për deputet nga radhët e Koalicionit LDK-AKR është vendosur në objekte dhe në rrugë publike e cilat shfrytëzohen për shërbime publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike, brenda ose jashtë ndërtesave dhe objekteve publike ose godinave”*

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posterat e kandidatit për deputet nga ky koalicion janë vendosur në objekte dhe në rrugë publike.

Paneli e urdhëroi koalicionin LDK-AKR, për ta përmirësuar shkeljen e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, ku i njëjti brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime e duhura për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë posterat nga vendi ku ka ndodhur shkelja, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e Blerim Graincës kandidatit për deputet nga koalicioni LDK-AKR, janë vendosur në objekte dhe në rrugë publik në drunj, dhe në kiosqe, dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të koalicionit në fjalë që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.30/2017 më datën 05.06.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.